

## RUBRIKA I

## TESTI I INTELIGJENCES

## TEZA 3

1. Cili është numri që mungon në këtë seri numrash: "19, 16, ?, 10, 7, ... "

- a) 11;                      b) 12;                      c) 13;                      d) 14.

2. Cili matematicien njihet të ketë thënë "Eureka"?

- a) Arkimedi;  
b) Pitagora;  
c) Ainshtajni;  
d) Xheison.

3. Cili është numri i parë në këtë seri numrash "? , 14, 16, 27, 9, 18, 32, 8, 24"?

- a) 30                      b) 17                      c) 19                      d) 21

4. Një balenë është:

- a) Gjitar  
b) Peshk  
c) Dinosaur  
d) Amfib

5. Nëntë numrat në anën e majtë të tabelës lidhen me njëri tjetrin në një mënyrë të caktuar. Gjeni sesi funksionojnë këto nëntë numra në anën e majtë të tabelës. Nëntë numrat në anën e djathtë të tabelës funksionojnë ekzaktësisht në të njëjtën mënyrë. Cili numër duhet të zëvendësojë pikëpyetjen?

4	2	6	7	5	?
5	2	8	8	8	8
6	1	11	9	10	8

- a) 12  
b) 8  
c) 9  
d) 11

6. Cili nga lumenjtë e mëposhtëm është më i gjatë?

- a) Vjosa  
b) Buna  
c) Mati  
d) Erzeni



**7. Mosha e pesë pjesëtarëve të familjes është në total 107 vjet.**

Mosha e Margaretës dhe Stuartit në total është 29 vjet.

Mosha e Stuartit dhe Xhefrit në total është 44 vjet.

Mosha e Xhefrit dhe Brianit në total është 57 vjet.

Mosha e Brianit dhe Filipit në total është 46 vjet.

Sa është mosha e secilit pjesëtar të familjes?

- a) Filipi 21, Xhefri 40, Stuarti 14, Briani 25, Margareta 36
- b) Margareta 17, Stuarti 12, Xhefri 32, Briani 25, Filipi 21
- c) Briani 23, Xhefri 56, Filipi 23, Margareta 17, Stuarti 12
- d) Stuarti 12, Margareta 17, Filipi 26, Xhefri 32, Briani 20

**8. Ku është vendosur Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut?**

- a) Strasburg
- b) Bruksel
- c) Luksemburg
- d) Hagë.

**9. Cili organ sekreton insulinë:**

- a) Veshka
- b) Mëlçia
- c) Pankreasi
- d) Shpretkë

**10. Cili numër duhet të vijë në radhë në këtë seri numrash: "17, 18, 21, 26, 33, ?"**

- a) 35
- b) 37
- c) 39
- d) 42





**RUBRIKA II**  
**LEGJISLACIONI I BE, MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE,**  
**E DREJTË E KRAHASUAR DHE HISTORI**

**TEZA 17**

**LEGJISLACIONI I BE**

/ 1. Nga liria e vendosjes (neni 49 TFBE, ish neni 43 TKE) përfitojnë:

- a. Vetëm personat fizikë
- b. Vetëm personat juridikë
- c. Vetëm OJF
- d. a + b

/ 2. Liria e ofrimit të shërbimeve (neni 56 TFBE, ish neni 49 TKE):

- a. Ndalon kufizimet mbi lirinë e ofrimit të shërbimeve brenda BE
- b. Lejon kufizimet mbi lirinë e ofrimit të shërbimeve vetëm ndaj personave që nuk kanë shtetësinë europiane
- c. Lejon Komisionin Europian të shtrijnë dispozitat e kësaj dispozite ndaj shtetasve të një vendi të tretë
- d. Të gjitha alternativat e mësipërme.

/ 3. Për çfarë arsye Shtetet Anëtare mund të kufizojnë të drejtat e lëvizjes së lirë?

- a. Shkaqet ekonomike.
- b. Shkaqe mjedisore.
- c. Politika publike, siguria publike ose shëndeti publik.
- d. Shkaqe arsimore.

**E DREJTË NDËRKOMBËTARE PUBLIKE**

/ 4. Në Shërbimin me Qëllim të Mirë, pala e tretë:

- a) Afron palët në bisedime.
- b) Afron palët në bisedime, merr pjesë në to dhe propozon edhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes
- c) Propozon referimin e mosmarrëveshjes në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

/ 5. “Rezerva e juridiksionit të detyrueshëm” të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë:

- a) Duhet të përcaktohet nga Këshilli i Sigurimit të OKB.
- b) Duhet të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme e OKB.
- c) Bëhet në mënyrë të njëanshme.

/ 6. Zona e Fqinjë (e Puqur) shtrihet brenda:

- a) Zonës Ekonomike Ekskluzive
- b) Zonës
- c) Shelfit Kontinental.



**RUBRIKA II**  
**LEGJISLACIONI I BE, MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE,**  
**E DREJTË E KRAHASUAR DHE HISTORI**

**E DREJTË E KRAHASUAR**

7. Gati një e treta e popullsisë së botës jetojnë në rajone ku e drejta ndikohet më fort nga Common Law:
- a. E vërtetë;
  - b. E gabuar.
8. E drejta e krahasuar legislative fillon në Gjermani në:
- a. Shekullin e 18;
  - b. Shekullin e 19;
  - c. Shekullin e 20.

**HISTORI**

9. Aktet themeluese të Lidhjes së Prizrenit ishin:
- a. Kurani;
  - b. Kanunameja;
  - c. Karamameja;
  - d. Kuvendi.
10. E drejta e shkruar në Athinën e Lashtë u shfaq për herë të parë:
- a. Me reformat e Klisthenit;
  - b. Me reformat e Tezeut;
  - c. Me Ligjin e 12 tabelave;
  - d. Me ligjet e Drakonit.





### RUBRIKA III – GJUHA SHQIPE

#### TEZA 7

21. Në fjalitë e mëposhtme dalloni përemrin vetor:

- A) Më mësoi mirë ai pedagog.
- B) Është me talent ai djalë.
- C) Ai atje të të drejtojë automjeti.
- D) Ai është kudo ku e kërkojnë.

22. Dalloni përemrin që ka një formë për të dy gjinitë:

- A) Asnjëri;    B) Ndonjëri;    C) Secili;    D) Askush.

23. Fjala “jam” në fjalinë: “Jam mësuar me të tilla gjëra.” është:

- A) Ndhmëse;
- B) Gjysmëndihmëse;
- C) Me kuptim të plotë;
- D) Asnjëra.

24. Ç’janë antonimet: përpjetë- tatëpjetë; afër-larg:

- A) Mbiemra;    B) Parafjalë;    C) Emra;    D) Ndajfolje.

25. Sa lidhëza bashkërenditëse gjenden në tekstin e mëposhtëm?

“Sendi i përbashkët administrohet sipas mënyrës së miratuar me marrëveshjen e të gjithë bashkëpronarëve dhe kur kjo nuk është arritur, sipas mënyrës së caktuar me vendim të bashkëpronarëve që kanë më shumë se gjysmën e vlefës së tij. Vendimi i shumicës është i detyrueshëm edhe për bashkëpronarët që kanë mbetur në pakicë.”

- A) 1;    B) 2;    C) 3;    D) 4.

26. Fjalët : mirë, bukur, shpejt, janë:

- A) Të thjeshta;
- B) Të përngjitura;
- C) Të prejardhura;
- D) Të përbëra.

27. Gjeni sa trajta të shkurtra janë përdorur në fjalinë e mëposhtme:

“Çdo person fizik ka të drejtën dhe detyrimin të ketë emrin dhe mbiemrin e tij që i vihen sipas ligjit. Personi, të cilit i mohohet e drejta e përdorimit të tyre ose çënohet nga përdorimi që të tjerët i bëjnë padrejtësisht, mund të kërkojë në gjykatë përdorimin e emrit ose të mbiemrit të vet, pushimin e cënimit, si dhe shpërblimin e dëmit përkatës.”

- A) 1;    B) 3;    C) 5;    D) 7.

### RUBRIKA III – GJUHA SHQIPE

28. Qarkoni fjalinë që ka kundrinor të drejtë:

- A) Popullit i duhet thënë.
- B) Shtëpia me lule është diçka e bukur.
- C) Lexonte librin e mbante shënime.
- D) Mësoi mirë pa fitoi.

29. Dalloni fjalinë me foljen pavetore:

- A) Në dimër netet janë të gjata.
- B) Dimri sivjet ishte i ftohtë.
- C) Në dimër bën ftohtë.
- D) Nuk kuptohet dimri pa të ftohtë.

30. Në ç'klasë bën pjesë fjala e nënvizuar në fjalinë: “Kape atë zog aty pranë.”:

- A) Ndajfolje;
- B) Parafjalë;
- C) Emër;
- D) Mbiemër.

31. Në cilën fjali ka folje ndihmëse?

- A) Ky ishte urdhëri i pedagogut.
- B) Për lajmet ju jeni specialiste.
- C) Në dhomë nuk kishte njeri.
- D) Sytë akoma nuk ishin ngopur me dritë.

32. Cila formë shpreh moskryerjen e një veprimi?

- A) Pjesorja;
- B) Mohorja;
- C) Paskajorja;
- D) Përcjellorja.

33. Cili është funksioni i fjalëve të nënvizuara në fjalinë: “Të tëra shtëpitë janë zhytur në një gjelbërim të këndshëm.”?

- A) Rrethanor sasie;
- B) Kundrinor i drejtë;
- C) Kryefjalë;
- D) Kallëzues.

34. Gjeni përemrin e pacaktuar në fjalitë:

- A) Ç'do këtu?
- B) Çdo njeri e kupton gabimin që bën.
- C) Ç'do mësuesja në shtëpine time?



### RUBRIKA III – GJUHA SHQIPE

D) Ç'more sot në provim?

35. Cili është përemër dëftor?

- A) Tuaja;      B) Atë;      C) Juaj;      D) Dikush.

36. Ndajfoljet: *gjithnjë, ngadalë, askund, menjëherë, papritur, kurrkund, janë:*

- A) Ndajfolje kohe;  
B) Ndajfolje mënyre;  
C) Fjalë të përngjitura;  
D) Fjalë të prejardhura.

37. Në ç'skallë janë mbiemrat në fjalinë: "*Kjo këngë u bë më e përhapura dhe më e kënduara nga të gjitha.*" :

- A) Shkalla sipërore;  
B) Shkalla krahasore e barazisë;  
C) Shkalla krahasore e sipërores;  
D) Shkalla krahasore e ultësisë.

38. Cili përemër është në rasën kallëzore?

- A) Ne na;      B) Juve ju;      C) Atij i;      D) Prej jush.

39. Cili nga përemrat pyetës nuk ndryshon formë?

- A) Cili;      B) Kush;      C) Çfarë;      D) Tjetër.

40. Rrethoni alternativën që ka grup emëror:

- A) Shtiza e flamurit;  
B) Pranë detit;  
C) Kafshoi bukën;  
D) I shpejtë nga këmbët.





**RUBRIKA IV  
PSIKOLOGJI - KOMUNIKIM**

**TEZA 1**

41. Detyra e profiluesit është të:

- a. Rikonstruktojë dhe skicojë fytyrën e të dyshuarit;
- b. Analizojë dinamikën në sallën e hetimit dhe përshkruajnë mënyrën se si ato ndikojnë tek raportimi i të vërtetës;
- c. Analizojë skenën e krimit dhe të përcaktojë tiparet dhe modelet e sjelljes së kriminelit;
- d. Studiojë mendjen dhe sjelljen kriminale si dhe faktorët që ndikojnë tek ajo.

42. Studimet psikologjike tregojnë se gjyqtarët priren të:

- a. Nënvlërësojnë dëshminë e dëshmitarit okular;
- b. Mbivlerësojnë dëshminë e dëshmitarit okular;
- c. Gjykojnë në mënyrë të ekuilibruar dëshminë e dëshmitarit okular;
- d. Varet nga kujdesi dhe profesionalizmi i gjyqtarit.

43. Ekzaminimi i ciklit të Calliphoridae është një mjet që përdoret për përcaktimin e:

- a. Moshës së viktimës
- b. moshës së kriminelit
- c. kohës së vdekjes së viktimës
- d. kohës së vjedhjes

44. Sipas teorisë psikoanalitike sjellja devijante shkaktohet nga:

- a. Problemet në marrëdhënien e hershme fëmijë – prind;
- b. Dështimi në procesin e socializimit;
- c. Faktorë dhe procese biokimike dhe neurologjike;
- d. Kombinimi i faktorëve social, psikologjikë dhe biokimikë.

45. Lidhja midis inteligjencës së ulët dhe kriminalitetit mund të shpjegohet në shumë mënyra. Zgjidh alternativën e pasaktë.

- a. Kriminelët jo inteligjentë kapen më lehtë;
- b. Kriminelët jo inteligjentë pranojnë fajin më lehtë;
- c. Kriminelët jo inteligjentë janë të varfër dhe të paarsimuar;
- d. Kriminelët jo inteligjentë e humbasin kontrollin më lehtë;





**RUBRIKA IV**  
**PSIKOLOGJI - KOMUNIKIM**  
**TEZA 1**

46. Sipas modelit etologjik:

- a. Agresiviteti lind, akumulohet dhe shkarkohet natyrshëm në cikle periodike;
- b. Agresiviteti ka funksion adaptiv për evolucionin njerëzor;
- c. Aresivieti mësohet përmes përforcimeve dhe modelimit;
- d. Agresiviteti ka funksion normative që rregullon ndërveprimet sociale.

47. Pedofilët përgjithësisht janë:

- a. të shkathët;
- b. të shoqërueshëm;
- c. të ngathët;
- d. të turpshëm.

48. Cili nga pohimet e mëposhtme për personalitetin antisocial është i pavërtetë?

- a. Manifestimet e sjelljes antisociale shfaqen që në fëmijëri, apo adoleshencën e hershme;
- b. Diagnostikimi i çrregullimit të personalitetit antisocial mund të bëhet që në fëmijëri;
- c. Që të klasifikohet si çrregullim personaliteti, duhet që sjellja të mosjetë e ndikuar nga gjendje të tjera shëndetësore;
- d. Sjellja antisociale manifestohet në të gjitha sferat e jetës personale dhe profesionale.

49. Në ciklin e dhunës familjare, faza e muajit të mjalit, është faza në të cilën partneri i dhunshëm shfaqet i penduar dhe përpiqet të rifitojë besimin e partneres. Gjatë kësaj faze, detyra e organeve të drejtësisë është:

- a. Të ndihmojnë në ndërmjetësimin e pajtimin të partnerëve;
- b. Të presë deri në denoncimin e rradhës, nëse do të ketë një të tillë;
- c. Ti garantojë këshillim psikologjik gruas;
- d. Ti tregojë gruas foto të lëndimeve të saj, për t'i kujtuar që dhuna do të përsëritet.

50. Përfitimi nga aktet terroriste është:

- a. Ekonomik;
- b. Politik;
- c. Simbolik;
- d. Episodik.



RUBRIKA V  
ETIKË E SJELLJE QYTETARE

TEZA 2

Mbi rregullat e sjelljes dhe të etikës së prokurorit

Rrethoni pohimin e saktë:

51) *Prokurorët në ushtrimin me pavarësi të funksioneve apo detyrave të tyre, duhet që:*

- a) Të mbrojnë interesat e palës ;
- b) Të ushtrojnë funksionet e tyre, mbi bazën e vlerësimit të saktë të fakteve, në përputhje me kuptimin dhe zbatimin e drejtë të ligjit dhe të çliruar çdo ndikim i panevojshëm ose influencë e jashtme;
- c) Të shmangin çdo përpjekje të parregullt apo të paligjshme që mund të ndikojë ose manipulojë vlerësimet dhe vendimarrjen e tyre;
- d) Edhe b) edhe c);
- e) Asnjëra prej tyre.

52) *Prokurorët në ushtrimin me paanshmëri të funksioneve apo detyrave të tyre, duhet që:*

- a) Të jenë të paanshëm në përmbushjen e detyrave;
- b) Të duken që janë të paanshëm - të perceptohen të tillë nga opinioni publik;
- c) Të tejkalojnë paragjykimet kulturore që mund të ndikojnë në kuptimin dhe vlerësimin e fakteve, si dhe interpretimin apo zbatimin e ligjeve;
- d) Të gjitha më sipër;
- e) a) dhe b).

53) *Detyrime etike të prokurorit shtrihen:*

- a) Edhe në përkushtimin e një niveli të lartë profesional në ushtrimin e kompetencave të tyre;
- b) Rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve nuk parashikojnë detyrime për përpjekjet për nivelin profesional;
- c) Detyrimet etike lidhen vetëm me dukjen, perceptimin publik në zotërimin e një niveli të lartë profesional dhe;
- d) Asnjëra prej tyre.





- c) Edhe a) edhe b);
- d) Rregullat mbi etikën dhe sjelljen dhe etikës nuk parashikojnë në mënyrë të posaçme ndalime për sa më sipër;
- e) Asnjëra prej tyre.

59) Cili është pohimi më i saktë?

- a) Prokurorët nuk duhet të frekuentojnë ambiente apo lokale të papërshtatshme;
- b) Prokurorët kanë kufizime për përdorim ambientesh lokale të papërshtatshme vetëm brenda territorit të vendit;
- c) Rregullat mbi etikën dhe sjelljen për prokurorët nuk parashikojnë në mënyrë të posaçme një sjellje të tillë;
- d) Asnjëra prej tyre.

60) Cili është pohimi më i saktë?

- a) Prokurorët nuk duhet të përdorin apo hedhin të dhëna në rrjetet sociale elektronike (facebook, twitter, instagram, etj), të cilat dëmtojnë imazhin e tyre si prokuror;
- b) Prokurorët nuk kanë kufizime në përdorimin e platformave virtuale;
- c) Rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve nuk parashikojnë në mënyrë të posaçme një sjellje të tillë;
- d) Asnjëra prej tyre.



## RUBRIKA VI

### ADMINISTRATIVE - KUSHTETUESE

#### Teza 10

#### Gjeni pohimin e saktë

**61. Cili parim kufizon të drejtat themelore të individit për arsye të mbrojtjes së interesit publik:**

- a) parimi i përgjegjshmërisë,
- b) parimi i proporcionalitetit,
- c) parimi i paanësisë,
- d) parimi i mbrojtjes së sekretit shtetëror.

**62. Organet kolegjiale:**

- a) ndryshe nga organet monokratike, nuk mbështeten tek KPA për vendimmarrjet e tyre,
- b) mbështeten vetëm tek ligjet specifike, me të cilat janë krijuar në ushtrimin e detyrave të tyre,
- c) ndryshe nga organet individuale kanë vetëm një ligj bazë për organizimin dhe funksionimin e tyre, - Ligjin mbi organet kolegjiale,
- d) asnjëra prej tyre.

**63. Gjykata Kushtetuese:**

- a) nuk kontrollon në asnjë rast aktet administrative individuale,
- b) shqyrton aktet administrative normative,
- c) nuk ka të drejtë të rishikojë kushtetutshmërinë e asnjë akti administrativ,
- d) asnjëra prej tyre.

**64. Kur akti nxirret në zbatim të një vendimi gjyqësor, i cili ka deklaruar të pavlefshëm një akt administrativ:**

- a) akti nuk ka fuqi prapavepruese,
- b) akti ka fuqi prapavepruese,
- c) aktit mund t'i jepet fuqi prapavepruese,
- d) akti e merr fuqinë juridike, vetëm pasi vërtetohet një nga rastet e efektit të vonuar.

**65. Gjeni pohimin e saktë:**

- a) Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet.
- b) Paditë për mosmarrëveshjet administrative, që kanë për objekt mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm, që rrjedhin nga sendet e paluajtshme, shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin në të cilin organi publik ka selinë e tij,
- c) Kur kompetenca tokësore nuk mund të përcaktohet në këtë mënyrë, atëherë kompetente është gjykata, në territorin e së cilës ka kryer veprimin organi publik i paditur.





E DREJTA KUSHTETUESE

I. Rrethoni alternativën e saktë

- 66 Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga:
- a. Jo më pak se tre të pestat e të gjithë anëtarëve
  - b. Jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve
  - c. shumica e të gjithë anëtarëve
- 67 Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë vetëm kur kundër tij votojnë jo më pak se:
- a. Shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit
  - b.  $\frac{3}{5}$  e të gjithë anëtarëve të Kuvendit
  - c.  $\frac{2}{3}$  e të gjithë anëtarëve të Kuvendit
- 68 Ministër mund të caktohet kushdo që :
- a. ka mbushur të paktën moshën 25 vjeç
  - b. ka mbushur të paktën moshën 30 vjeç
  - c. ka cilësitë për deputet
- 69 Nisma për rishikimin e Kushtetutës mund të ndërmerret nga:
- a. Presidenti Republikës
  - b. Kryeministri
  - c. jo më pak se një e pesta e anëtarëve të Kuvendit
- 70 Si rregull, ligji hyn në fuqi:
- a. në jo më pak se 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare
  - b. ditën e botimit në Fletoren Zyrtare
  - c. pasi shpallet nga Presidenti i Republikës



## RUBRIKA VII

### E DREJTA FAMILJARE

Teza 29

71. **Është e vertetë se dispozitat e Kodit të Familjes për regjimet pasurore:**
- a. Mund të zbatohen me analogji edhe për bashkëjetuesit;
  - b. Mund të zbatohen plotësisht vetëm nëse parashikohen nga bashkëjetuesit në kontratën noteriale;
  - c. Nuk mund të zbatohen;
  - d. Mund të zbatohen edhe për bashkëjetuesit nëse kanë fëmijë të lindur nga bashkëjetesa.
72. **Rretho përgjigjen e gabuar.**
- a. Prindi është në pamundësi të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore kur ka vdekur.
  - b. Prindi është në pamundësi të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, kur është i pazotë për të vepruar.
  - c. Prindi është në pamundësi të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, për shkak se mungon.
  - d. Prindi është në pamundësi të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, për shkak të paafetësisë në degjim.
73. **Rretho përgjigjen e saktë: Bashkëshortët me marrëveshje:**
- a. Mund të shmangin disa të drejta dhe detyrime martesore;
  - b. Mund të vendosin që njëri bashkëshort të marrë më shumë prej detyrimeve që burojnë nga martesja;
  - c. Mund të parashikojnë detyrime për personat e tretë;
  - d. Asnjë më sipër.
74. **Rretho përgjigjen e gabuar.**
- a. Me birësimin detyrimisht ndryshohet identiteti i fëmijës.
  - b. Me birësimin ndryshohet detyrimisht mbiemri i fëmijës.
  - c. Me birësimin ndryshohet detyrimisht atësia dhe amësia e fëmijës.
  - d. Me birësimin detyrimisht ndryshohet edhe emri i fëmijës.





## RUBRIKA VII

### TEZA 29

#### E DREJTË TREGTARE

76. Në një shoqëri kolektive, përgjegjësia e ortakut para kreditorëve të shoqërisë është :
- a) përgjegjësi e kufizuar deri në vlerën e kontributeve të tij në kapitalin e shoqërisë;
  - b) përgjegjësi e pakufizuar;
  - c) përgjegjësi sipas përcaktimeve në statut;
  - d) asnjë prej tyre.
76. Veprimtaria tregtare e një shoqërie komandite administrohet nga :
- a) një ose me shumë ortak të pakufizuar;
  - b) një ose me shumë ortak të kufizuar;
  - c) ortakët e kufizuar dhe të pakufizuar së bashku;
  - d) asnjë prej tyre.
77. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) themelohet nga :
- a) vetëm persona fizik;
  - b) vetëm persona juridik;
  - c) persona fizik dhe juridik;
  - d) asnjë prej tyre.
78. Personi i autorizuar për të përfaqësuar shoqërinë:
- a) nuk mund të lidhë kontrata me të;
  - b) mund të lidhë me shoqërinë vetëm kontrata me vlerë të vogël;
  - c) mund të lidhë me shoqërinë kontrata pa kundërshtim;
  - d) mund të lidhë kontrata me shoqërinë vetëm pasi ka marrë miratimin nga organi kompetent.
- E DREJTË PUNE
79. Kontrata kolektive lidhet në nivel ndërmarrjeje ose dege, sipas:
- a) marrëveshjes së palëve kontraktuese;
  - b) marrëveshjes së palëve kontraktuese dhe me autorizim të ministrisë përgjegjëse për marrëdhëniet e punës;
  - c) marrëveshjes së palëve kontraktuese, me kusht që t'i shtrijë efektet në të gjithë territorin.
80. Paga përbëhet nga:
- a) paga bazë dhe shtesat me karakter të përhershëm;
  - b) paga bazë dhe shpërblimet që merr punëmarrësi për shpenzimet e kryera për shkak të veprimtarisë së tij profesionale;
  - c) paga bazë, shtesat me karakter të përhershëm dhe shpërblimet që merr punëmarrësi për shpenzimet e kryera për shkak të veprimtarisë së tij profesionale.



**RUBRIKA VIII**  
**PROCEDURË CIVILE DHE E DREJTË CIVILE**  
**TEZA 23**

**81) Gjeni fjalinë e saktë:**

- a. Afatet për kryerjen e veprimeve procedurale caktohen vetëm nga ligji;
- b. Afatet procedurale mund të jenë prekluzive, kur gjykata e përcakton këtë gjë me vendim;
- c. Afatet e vendosura nga ligji janë gjithmonë të zakonshme;
- d. Afatet e prera nuk mund të shkurtohen ose të shtyhen qoftë edhe me pëlqimin e palëve.

**82) Gjeni fjalinë e saktë:**

- a. Paditë me objekt kërkim të detyrimit ushqimor mund të ngrihen vetëm në gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri;
- b. Paditë me objekt shpërblim dëmi të shkaktuar nga dëmtimi i shëndetit mund të ngrihen vetëm në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi;
- c. Paditë që kanë për objekt kundërshtimin e veprimeve të kryera nga përmbaruesi për ekzekutimin e detyruar ngrihen në gjykatën e vendit të ekzekutimit.

**83) Gjeni fjalinë e saktë:**

- a. Kundër vendimit të gjykatës që refuzon marrjen pjesë të personit të tretë në gjykim, nuk mund të bëhet ankim;
- b. Kundër vendimit të gjykatës që refuzon marrjen pjesë të personit të tretë në gjykim, mund të bëhet ankim i veçantë;
- c. Kundër vendimit të gjykatës që refuzon marrjen pjesë të personit të tretë në gjykim, mund të bëhet ankim, vetëm së bashku me vendimin përfundimtar.

**84) Gjeni fjalinë e saktë:**

- a. Eksperti nuk mban përgjegjësi penale për ekspertimin që kryen;
- b. Eksperti mban përgjegjësi penale për ekspertimin që kryen, por jo përgjegjësi civile;
- c. Eksperti mban përgjegjësi penale dhe civile për ekspertimin e tij;
- d. Eksperti mban përgjegjësi civile për ekspertimin e tij por jo përgjegjësi penale;

**85) Gjeni fjalinë e saktë:**

- a. Sendi i paluajtshëm i debitorit, i sekuestruar nga përmbaruesi gjyqësor, nuk mund t'i lihet në ruajtje debitorit;
- b. Sendi i paluajtshëm i debitorit, i sekuestruar nga përmbaruesi gjyqësor, i lihet në ruajtje në çdo rast një personi të tretë, të ndryshëm nga debitori dhe kreditori;
- c. Sendi i paluajtshëm i debitorit, i sekuestruar nga përmbaruesi gjyqësor, nuk mund t'i lihet në ruajtje kreditorit;
- d. Asnjë nga alternativat e mësipërme.



## TEZA 23

### 86 Rrethoni alternativën e gabuar:

- a) Dispozitat që kanë të bëjnë me sendet e paluajtshme zbatohen edhe për të drejtat reale që lidhen me to.
- b) Dispozitat që kanë të bëjnë me sendet e paluajtshme zbatohen edhe për paditë përkatëse që lidhen me to.
- c) Dispozitat që kanë të bëjnë me sendet e paluajtshme nuk zbatohen edhe për paditë përkatëse që lidhen me to.

### 87 Rrethoni përgjigjen e saktë:

- a) Nëse kontrata e porosisë nuk përcakton shpërblim, atëherë presumohet se i porosituri nuk do të marrë shpërblim.
- b) Nëse kontrata e porosisë nuk përcakton shpërblim, atëherë shpërblimi përcaktohet nga tarifat profesionale dhe zakoni.
- c) Nëse kontrata e porosisë nuk përcakton shpërblim, atëherë shpërblimi përcaktohet nga porositësi.

### 88 Rrethoni përgjigjen e saktë:

- a. Pronari ka të drejtë të ngrejë padi për të kërkuar sendin e tij nga çdo posedues ose mbajtës me keqbesim.
- b. Pronari ka të drejtë të ngrejë padi për të kërkuar sendin e tij nga çdo posedues ose mbajtës.
- c. Pronari ka të drejtë të ngrejë padi për të kërkuar sendin e tij nga çdo posedues ose mbajtës me mirëbesim.

### 89 Rrethoni alternativën e gabuar:

- a) Heqja dorë nga trashëgimi mund të bëhet brenda 3 muajve nga çelja e trashëgimisë dhe kur trashëgimtari është jashtë shtetit, jo më vonë se 6 muaj.
- b) Për trashëgimtarin që në kohën e çeljes së trashëgimisë nuk ka lindur, afati i heqjes dorë nga trashëgimi fillon nga dita e lindjes.
- c) Heqja dorë nga trashëgimi mund të bëhet brenda 3 muajve nga çelja e trashëgimisë dhe kur trashëgimtari është jashtë shtetit, jo më vonë se një vit.

### 90 Rrethoni alternativën e gabuar:

- a) Pengu dhe hipoteka mund të vihen vetëm për një detyrim efektiv.
- b) Pengu ose hipoteka mund të garantojë një kredi ekzistuese ose një kredi të ardhshme.
- c) Pengu ose hipoteka nuk mund të vihet për një detyrim me kusht.



**RUBRIKA IX**  
**E DREJTË PENALE – PROCEDURË PENALE**  
**TEZA Nr. 9**

**91. Në rastin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit, kur nuk urdhëron lirin e menjëhershëm, prokurori kërkon vlefhtësimin e masës në gjykatë:**

- a) brenda 24 orëve nga çasti i arrestimit ose ndalimit,
- b) brenda 48 orëve nga çasti i arrestimit ose ndalimit,
- c) brenda 72 orëve nga çasti i arrestimit ose ndalimit,
- d) brenda 96 orëve nga çasti i arrestimit ose ndalimit,
- e) varet nga rëndësia e veprës dhe numri i autorëve, kur krimi është kryer në bashkëpunim.

**92. Është i pazoti për të dëshmuar?**

- a) i mituri nën moshën 14 vjeç;
- b) i mituri nën moshën 16 vjeç;
- c) i mituri nën moshën 18 vjeç;
- d) në çdo rast, prezumohet se i mituri ka zotësi për të dëshmuar.

**93. Mund të fitojë statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë:**

- a) çdo i pandehur madhor, me kushtin që të mos jetë përsëritës i posaçëm;
- b) vetëm të pandehurit e akuzuar për krime të kryera në formën e posaçme të bashkëpunimit;
- c) i pandehuri për të cilin vendimi i dënimit nuk ka marrë ende formë të prerë;
- d) çdo i pandehur, i akuzuar për një krim të kryer në bashkëpunim që, në maksimum, dënohet jo më pak se 7 vjet burgim;
- e) vetëm i pandehuri për të cilin nuk është vendosur ende gjykimi i çështjes.

**94. Sekuestroja konservative vendoset:**

- a) vetëm me kërkesë të prokurorit;
- b) me kërkesë të prokurorit ose të paditësit civil;
- c) me kërkesë të prokurorit, por vetëm me qëllimin për të garantuar pagimin e shpenzimeve procedurale;
- d) kryesisht nga gjykata, por vetëm kur nuk ka garanci për pagimin e detyrimeve ndaj pasurisë së shtetit.

**95. Lidhur me procedurën e marrjes të kampionëve biologjikë është i vërtetë pohimi:**

- a) marrja e kampionëve biologjikë nga i pandehuri mund të kryhet, në çdo rast, edhe pa pëlqimin e tij;
- b) kampioni nuk mund të merret pa pëlqimin e tij, të dhënë qoftë edhe me gojë;
- c) mund të merren me detyrim, por vetëm pasi të jetë dhënë miratimi nga gjykata;
- d) prania e mbrojtësit gjatë procedurës varet nga vullneti i të pandehurit;
- e) prokurori nuk ka të drejtë të urdhërojë shoqërimin e personit, të cilit do t'i merret kampioni biologjik, përveç rastit kur personi është i pandehuri.





**96. Lidhja shkakësore është:**

- (a) Një nga elementët e domosdoshëm të anës objektive të veprës penale;
- (b) Lidhja që ekziston mes shkakut dhe pasojës;
- (c) Element i veprës penale ekzistenca e të cilit përcakton përgjegjësinë penale të një individi;
- (d) Të gjitha alternativat janë të sakta;
- (e) Asnjë alternativë nuk është e saktë.

**97. Alternativa të dënimit me burgim janë:**

- a) Ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji;
- b) Heqja e të drejtës për të ushtruar funksione publike;
- c) pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim;
- d) Të gjitha alternativat janë të sakta.

**98. Vrasja me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme karakterizohet nga:**

- a) Kryerja e veprës penale duke u nxitur nga veprimet provokuese të viktimës;
- b) Kryerja e veprës penale për të shmangur një sulm të padrejtë, të çastit dhe të vërtetë, ku karakteri i mbrojtjes është në përpjesëtim me karakterin e sulmit;
- c) Kryerja e veprës penale për t'u mbrojtur, kur sulmi i padrejtë nga ana e viktimës ka përfunduar.

**99. Vepra penale e "Mospagimit të taksave dhe tatimeve" kryhet:**

- a) Me veprime aktive të cilat synojnë shmangien e detyrimeve fiskale dhe të detyrimeve tatimore, të cilat i janë ngarkuar subjektit tatimor;
- b) Nga subjekte të posaçme, personat që janë të detyruar të vjelin detyrimet fiskale nga personat fizik apo juridik, të cilët janë të detyruar me ligj t'i paguajnë ato detyrime;
- c) Me mosveprime të subjektit, duke mos paguar detyrimin tatimor, ndonëse ka edhe një dënim administrativ ndaj tij dhe ky subjekt vazhdon të mos i paguajë këto detyrime, megjithëse i ka mundësitë për pagimin e tyre.

**100. Vepra penale "Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete" konsiderohet e kryer:**

- a) Kur përveç zbulimit të të dhënave apo akteve sekrete, kanë ardhur edhe pasoja të rënda për jetën apo shëndetin e dëshmitarëve apo të bashkëpunëtorëve të drejtësisë apo personave të tjerë;
- b) Kur funksionari publik ka zbuluar të dhëna ose akte sekrete në kundërshtim me përbushjen e rregullit të detyrës së tij, ndërsa ardhja e pasojave të tjera kriminale është një rrethanë cilësuese e kësaj vepre;
- c) Kur funksionari publik ka zbuluar të dhëna ose akte sekrete në kundërshtim me ligjin, me qëllim për të dëmtuar jetën apo shëndetin e dëshmitarëve apo bashkëpunëtorëve të drejtësisë apo personave të tjerë.